

## **ANEKSI 23**

### **TOLERANCAT E GABIMIT TË MATËSIT ELEKTRIK GJATË VERIFIKIMIT**

- 1. Saktësia e matësive të energjisë elektrike do të verifikohet në përputhje me kërkesat e Standardit IEC 62053 ose EN 50470.**
- 2. Për matësat që verifikohen në laborator, nëse nuk e kalojnë provën e izolacionit me tension ose provën e ndjeshmërisë, ose provën e punimit pa ngarkesë, atëherë matësat do të konsiderohen jo të rregullt. Prova e izolimit do të kryhet me tension 2000 V për matësat e rinj dhe 600 V për matësat në përdorim. Prova pa ngarkesë do të kryhet me ngarkesë zero dhe tension prove sipas kushteve të përcaktuara në IEC 62053 ose EN 50470.**
- 3. Për matësat që verifikohen në laborator, nëse gjatë provës me ngarkesë, gabimi në (%) tejkalon tolerancat e pranura për klasën e saktësisë dhe llojit të matësit (elektromekanik apo statik) në Standardin IEC 62053 ose EN 50470, qoftë edhe në një pikë testimi, atëherë matësi elektrik do të konsiderohet jo i rregullt.**
- 4. Për matësat që verifikohen në terren (pa e shkëputur matësin nga sistemi i matjes), nëse gjatë testimit të matësit me ngarkesë, gabimi në (%) i matur me instrument etalon tejkalon 1.5 herë klasën e saktësisë së matësit elektrik që testohet, atëherë matësi elektrik do të konsiderohet jo i rregullt dhe do të zëvendësohet nga Operatori i Rrjetit.**